

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)68 20 67 630
E-mail: info@qkzh.org

www.qkzh.org

Rezultatet e vrojtimit të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 24 qershor 2007




*Business and Consumer
Survey Results
No 24, June 2007*

INDUSTRIA PËRPUNUESE

MANUFACTURING SECTOR

FIGURA 1: Treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacture



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Klima e biznesit në industri vazhdon të përmirësohet dhe të mbetet në vlera pozitive për të pestin tremujor në vazhdim. Treguesi i besueshmërisë për këtë sektor është në vlera më të larta se vlera mesatare në vite (2002-2006). Pas një rënie në janar 2007, treguesi i besueshmërisë në sektorin e industrisë përpunuese është përmirësuar duke u vlerësuar me balancën e përgjigjeve prej 12 pikësh.

Ky tregues është edhe më i lartë se një vit më parë, në prill 2007 me 8 pikë në përqindje, ku balanca e përgjigjeve shënonte vetëm 4 pikë. Në përmirësimin e këtij treguesi për periudhën e prill 2007 ka ndikuar ndjeshëm vlerësimi mjaft i lartë për parashikimin e aktivitetit të biznesit në sektorin e industrisë përpunuese. Ky fakt mund të interpretohet dhe me pritshmërinë e lartë që biznesi ka për rritjen e prodhimit kundrejt rritjes së kërkesës për sezonin e verës.

Treguesit e besueshmërisë për degët e industrisë ushqimore, industrisë tekstile dhe të fabrikimit të artikujve prej druri, kanë të njëjtat tendenca si dhe treguesi i besueshmërisë në total të industrisë për tre tremujorët e fundit. Në të tre këto degë të industrisë përpunuese pohohet nga drejtuesit e intervistuar një përmirësim i situatës së biznesit të tyre ku më i dukshëm është në degën e fabrikimit të artikujve të drurit me 23 pikë në përqindje më shumë në prill të 2007 ndaj janar 2007.

Edhe në degën e **industrisë së letrës dhe kartonit** vazhdon një përmirësim i situatës së biznesit nga -4 pikë në tetor 2006, në 0 pikë në janar 2007, duke arritur vlerën 41 pikë në prill 2007, vlerë kjo më e larta për katër vitet e fundit për këtë degë.

Mbetet në vlera negative (-6 pikë) treguesi i besueshmërisë për metalurgjinë, punimin metaleve, fabrikimi makinave, etj.

Më keq paraqitet situata në degën e **fabrikimit të artikujve mineralë jo metalikë** (prodhimi i tullave, çimentos dhe elementeve të tjera me beton për ndërtim) me -15 pikë, duke pësuar një rënie prej 26 pikësh në përqindje nga tremujori i kaluar. Kjo degë, e lidhur ngushtë me veprimtarinë ndërtuese, për këtë tremujor duket se është ndikuar nga vlerat e ulta të kontraktimeve si dhe vlerësimi i lartë i produktit të gatshëm (stoku).

Parashikimi i prodhimit për 3 muajt e ardhshëm

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e prodhimit në 3 muajt e ardhshëm, në muajin prill 2007 është rritur këtë herë me 18 pikë në krahasim me 3 muaj më parë, duke arritur nivelin e 47 pikëve. Ky nivel është 12 pikë më i lartë se një vit më parë, gjë që vazhdon të tregojë për një tendencë të qartë rritjeje të sektorit të industrisë përpunuese edhe në këtë tremujor. Nga grafiku që jep parashikimin e aktivitetit të prodhimit për gjithë periudhën janar 2002- prill 2007, duket qartë që për këtë tregues, vlerësimi maksimal është arritur në muajin prill për çdo vit.

Vlerësimi i nivelit aktual të kontraktimeve në muajin prill 2007 ka një rënie të mëtejshme, duke u influencuar negativisht nga mungesa e energjisë elektrike këtë fillim viti. Ai vlerësohet me -28 pikë në anketimin e prill 2007. Prodhuesit, në mënyrë të vazhdueshme kanë qenë të pa kënaqur nga sasia e kontratave të lidhura për prodhimet e tyre, duke e reflektuar këtë në vlera gjithmonë negative të balancës së përgjigjeve për të gjithë periudhën që QKZH ka kryer anketime, janar 2002 - prill 2007.

FIGURA 2: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing branches




FIGURA 3: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing branches






FIGURA 4: Parashikimi i aktivitetit të biznesit në industrinë përpunuese
Expectation of business activity in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 5: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë
Assesment of order-books in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Produktet e gatshme

Vlerësimi i produktit të gatshëm për muajin prill 2007 rezulton me -18 pikë, vlerësim që është 20 pikë në përqindje më i ulët se tremujorin e kaluar si dhe 7 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë. Kurba e vlerësimit të stokut është një kurbë me shumë ndryshime dhe e çrregullt, duke mbartur në përgjithësi vlerat negative të balancës së përgjigjeve, si dhe vete volatilitetin e prodhimit të ekonomisë shqiptare.

Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në 3 muajt e mëparshëm


Balanca e përgjigjeve në lidhje me vlerësimin e aktivitetit për tremujorin e kaluar, pra për periudhën janar-mars 2007, rezulton në vlerën negative prej 7%. Kjo vlerë është 35 pikë në përqindje më e ulët se një tremujor më parë dhe 11 pikë në përqindje më e ulët se një vit më parë. Rënia e vlerësimit të aktivitetit të prodhimit për 3 muajorin e kaluar, mund të shpjegohet me problemet e energjisë elektrike që u përball biznesi në janar 2007.

Kapacitetet prodhuese

Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese mbetet në nivele të larta. Për prill 2007, ky tregues ka vlerën prej 64%. Ka ndryshime të pa konsiderueshme nga tremujori në tremujor të përqindjes së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, konkretisht me 3 pikë në përqindje më pak se tremujori i kaluar dhe vetëm 1 pikë në përqindje më pak se një vit më parë. Në fakt, tendenca në përmirësim vërehet që nga janar-prilli i 2004.


E parë sipas degëve të industrisë, vërehet që vlerat aktuale të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në përgjithësi janë më afër vlerës maksimale të periudhës janar 2002 – prill 2007. Për këtë tremujor ato variojnë nga 40% në 76.2%. Për industrinë ushqimore, të pijeve dhe duhanit si dhe atë të fabrikimit të artikujve prej druri, mobiljeve, etj, vlera maksimale e shfrytëzimit është arritur pikërisht në këtë tremujor, pra në prill 2007. Industria e letres, kartonit, botimeve, kimike, kaucukut dhe plastikës, rafinimi i naftës dhe koksifikimi ka një rënie të ndjeshme të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese nga prill 2006 me 61% në prill 2007 me vetëm 40%. Shfrytëzimin më të lartë të kapaciteteve prodhuese e realizon industria e tekstileve, veshjes dhe lekurë këpucëve me 76.2%.

FIGURA 6 Vlerësimi i produkteve të gatshme në industrinë përpunuese
Assesment of stocks in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 7: Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në 3 muajt e kaluar
Assesment of production activity in manufacturing sector the last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 8 : Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Capacity utilisation in manufacture - total




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 9: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese sipas degëve të industrisë përpunuese, 2002-2006
Capacity utilisation in manufacturing branches 2002-2006



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstileve dhe lekurë këpucëve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobiljeve
21-25 industria e letres, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi i metaleve, pajisjeve elektrike

FIGURA 10: Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Assessment of production capacity in manufacture - total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 11: Parashikimi i çmimeve të shitjes në industrinë përpunuese
Assessment of selling prices expectations






FIGURA 12: Parashikimi i punësimit në industrinë përpunuese
Employment expectations in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 13: Parashikimi i kontratave për export në industrinë përpunuese
Export expectation in manufacture - total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese

Numri i bizneseve që i gjykojnë kapacitetet e tyre prodhuese më se të mjaftueshme, ka rënë me 10 pikë në përqindje nga janari në prill 2007 dhe ka rënë nën vlerën e mesatares disa vjeçare 2002-2006, duke treguar për një shkallë të lartë të shfrytëzimit të këtyre kapaciteteve. Kjo konfirmohet dhe nga vlerat e larta të shfrytëzimit të kapaciteteve aktuale në përgjithësi (shiko figurën 9)

Çmimet e prodhimit

Në lidhje me parashikimin e çmimeve të shitjes së produkteve të tyre, prodhuesit shprehen për një rritje në tre muajt në vazhdim. Balanca e përgjigjeve pozitive dhe negative tregon një përsheptim në rritje me 25 % dhe 18 % perkatesisht në janar dhe prill të 2007. Krahasuar me një vit më parë kemi një rritje me 18 pikë në përqindje të cilat mund të kenë influencuar në shkallën e inflacionit. Prodhuesit, në mënyrë të vazhdueshme, që nga prill 2005, kanë parashikuar rritje të çmimeve të produkteve të tyre pavarësisht se me ritme më të ulta apo më të larta rritjeje.

Punësimi në 3 muajt e ardhshëm

Balanca e përgjigjeve në lidhje me parashikimin e punësimit për tremujorin e ardhshëm vazhdon të mbetet pozitiv me 8%. Krahasuar me vlerësimin për parashikimin në anketimin paraardhës, mund të thuhet që do të ketë tendencë rritjeje me ritme më të ulta.

Parashikimi i kontratave për eksport

Prodhuesit, të cilët eksportojnë produktet e tyre shprehen optimist në lidhje me pritshmërinë që kanë për sasinë e kontratave për tremujorin në vazhdim. Balanca e përgjigjeve në lidhje me këtë tregues është vlerësuar me 44 %. Në përgjithësi parashikimet e nivelit të kontraktimeve për eksport paraqiten me luhata të theksuara nga një tremujor në tjetrin, gjë që flet se ecuria e eksporteve për këtë sektor është akoma e paqëndrueshme, megjithëse shikohen disa tendenca në stabilizim të nivelit të kontraktimeve në dy tremujorët e fundit.

Niveli i kontraktiveve në 3 muajt e kaluar

Ka një rënie të ndjeshme të vlerësimit të nivelit të kontratave për tre mujorin e kaluar nga vlera pozitive prej 28 pikësh në janar 2007, në -15 pikë në prill të 2007. Gjendja është e përkeqësuar në krahasim me tremujorin e kaluar me 43 pikë në përqindje. Duket se kjo situatë është influencuar shumë negativisht nga problemi i energjisë në fund të 2006 dhe fillim të 2007. Megjithatë, figura 14 tregon se kjo situatë rënie në vlerësim paraqitet thujtse për cdo vit në këtë periudhë(faktor sezonal), ku gjendja më e rënduar është paraqitur në prill 2004.

Niveli i prodhimit i vlerësuar në muaj pune

Gjatë periudhës korrik 2006 – prill 2007 vihet re një rënie e lehtë e vazhdueshme e kohës së kontraktuar për prodhim. Megjithatë, me 8.9 muaj pune të siguruar në industrinë përpunuese, prodhuesit mbeten optimist në lidhje me ecurinë e mëtejshme të prodhimit të tyre. Kjo vlerë është e njëjtë me atë të një viti më parë, prill 2006 dhe vazhdon të mbetet mbi vlerën e mesatares 2002 – 2006.

Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm

Për firmat e intervistuar nga sektori i industrisë përpunuese, balanca e përgjigjeve për pozicionin konkurrues në tregun e brendshëm është pozitive me 34 pikë. Ka një rritje të optimizmit prej 29 pikësh në përqindje krahasuar me një tremujor më parë. Krahasuar me një vit më parë, prill 2006 kjo rritje optimizmi shprehet edhe më e fortë, me 33 pikë në përqindje më shumë. Tendencat në rritje të optimizmit të prodhuesve për përmirësimin e pozicionit të tyre në këtë treg, me pak devijime, duken që nga prill 2006.

Pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm

Për firmat e intervistuar, pozicioni konkurrues në tregun e huaj, në EU apo edhe jashtë EU, në tremujorin e fundit është pozitiv, shprehur me vlera të balancës së përgjigjeve përkatësisht 19% (brenda tregut të EU) dhe 30% (jashtë tregut të EU). Binomi i këtyre vlerave shpreh një pasqyrë optimale për të ardhmen e firmave në të dy drejtimet e synuara, edhe pse grafiket pasqyrojnë ritme më të ulta rritjeje për pozicionin konkurrues në mardhënie me tregun e jashtëm në krahasim me një tremujor më parë. Optimizmi për rritjen e kontratave për eksport në vazhdim, mbështet ndjesinë e prodhuesve për përmirësim të pozicionit të tyre edhe në tregun e huaj.

FIGURA 14: Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në industrinë përpunuese 3 muajt e kaluar
Assesment of order-books in manufacture last 3 months





FIGURA 15: Vlerësimi i nivelit të prodhimit në muaj në industrinë përpunuese
Assesment of months of production in manufacture - total




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 16: Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm në sektorin e industrisë përpunuese
Domestic competitive position in manufacture - total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 17: Pozicioni konkurrues në tregun e jashtëm në sektorin e industrisë përpunuese
Competitive position on foreign market



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Pengesat në sektorin e industrisë përpunuese

Constraints within manufacturing sector


Gjatë vlerësimit të pengesave të hasura në sektorin e industrisë prodhuesit konfirmojnë se pengesat kryesore për rritjen e biznesit të tyre për periudhën prill 2007 rezultojnë të jenë, të radhitura si më poshtë: (i) **kërkesa e pamjaftueshme nga tregu i brendshëm** kjo gjendje për periudhën prill 2007, në mesataren e saj vlerësohet rreth 42 % (figura 22). Kjo pengesë është më e ndjeshme për sektorët e industrisë ushqimore, e pijeve dhe duhanit ku në këtë nëndegë të industrisë llogaritetet në 57 % në

grupin tjetër si atë të metalurgjisë, pajisjeve elektrike, etj në 48 %;

(ii) **mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar** me vlerën prej 40 % (figura 30) ku dega e industrisë së letrës, kartonit, botimeve, kimike, kaucukut dhe plastikës, rafinimi i naftës dhe koksifikimi e ndjen në masën 67 % dhe ajo e veshjeve dhe këpucëve shprehet në masën 63 % ;


(iii) **vështirësitë financiare** me mesataren e saj 38 % (figura 34), mesatare kjo e rritur mjaft ndjeshëm së fundi

Figura 18: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal
The impact of fiscal legislation in manufacture - total




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 20: Ndikimi i tregut informal
The impact of informal sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 22: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brenda vendit
Insufficient domestic demand-total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


FIGURA 19: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of fiscal legislation in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijeve

15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mc


FIGURA 21: Ndikimi i tregut informal sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of informal sector in manufacturing branches



115-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijeve

21-25 industria e letrës, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

FIGURA 23: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brenda vendit sipas degëve të industrisë përpunuese
Insufficient domestic demand in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijeve

21-25 industria e letrës, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek


gjë që dëshmon edhe një herë vështirësitë e biznesit për të marrë kredi si dhe kushtet e vështira të dhënies së kredisë (normat e interesit etj.). Më e ndjeshme ndaj kësaj vështirësie mbetet përsëri dega e industrisë së letrës, kartonit, botimeve, kimike, kaucukut dhe plastikës, rafinimi i naftës dhe koksifikimi, që shprehet në masën 68.7 %; (iv) **mungesat në infrastrukturë** (figura 24), megjithëse vjen e zvogëluar nga një tremujor më parë. Mungesa e infrastrukturës së duhur vazhdon të jetë një pengesë reale për prodhuesit. 37 % e të intervistuarve shprehin shqetësimin e tyre për këtë problem. Edhe për këtë pengesë, më fuqishëm shprehen prodhuesit në degën e industrisë së letrës, kartonit, botimeve, kimike, kaucukut

FIGURA 24: Ndikimi i mungesës së infrastrukturës në sektorin e industrisë




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 26: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 28: Ndikimi i korrupsionit në sektorin e industrisë përpunuese



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

dhe plastikës, rafinimi i naftës dhe koksifikimi, në masën 77 %, megjithëse dukej që prej një viti si një pengesë në zhdukje për këtë degë.

(v) Ndikimi i mungesës së **energjisë elektrike** për muajin prill 2007 është ulur në vlerën e 35 % -it (figura 32), që është 45 pikë në përqindje më pak se muajin janar të këtij viti. Siç del edhe nga figura, ulja drastike e ndikimit të mungesës së energjisë elektrike është mjaft pozitive po të krahasohet me një vit më parë ku shifra e muajit prill 2006 kapte vlerën e 52 % -it, që do të thotë rreth 17 pikë në përqindje më e lartë se këtë vit. Edhe pse këto shifra janë optimiste, është shumë herët për ta konsideruar këtë ulje si një fenomen që do të ketë një

FIGURA 25: Ndikimi i mungesës së infrastrukturës sipas degëve të industrisë përpunuese




FIGURA 27: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm sipas degëve të industrisë përpunuese





FIGURA 29: Ndikimi i korrupsionit sipas degëve të industrisë përpunuese



kurbë gjithnjë e më në rënie për periudhën në vazhdim, pasi faktori sezonal e ka krijuar këtë avantazh dhe jo përmiresimi real i infrastrukturës së elektricitetit.


(vi) Balanca e përgjigjeve në lidhje me impaktin që ka **keqzbatimi apo keq hartimi i legjislacionit fiskal** gjatë muajit prill 2007 është në vlerën e 25 pikëve, që do të thotë 6 pikë në përqindje më e lartë se tremujorin e kaluar por 24 pikë në përqindje më poshte se muaji prill 2006.

(vii) **Korrupsioni (kryesisht nga organet tatimore)** duket se po e ul në vazhdimësi ndikimin e tij pengues.

Kjo tendencë po vihet re qartazi edhe në anketimin e muajit prill 2007 ku këtë faktor e kanë cilësuar vetëm 8.6% e të anketuarve. Kjo vlerë shënon edhe vlerën më të ulët të gjithë periudhës së anketimeve, gjë që tregon se ky shqetësim mund të konsiderohet pa ndikimi në ecurinë e mirë të aktivitetit prodhues në sektorin e industrisë përpunuese.


(viii) Rënia e ndikimit të kufizues të **kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm**, me 6 %, tregon që eksportet mbështesin zhvillimin pozitiv aktual të ekonomisë.

FIGURA 30: Ndikimi mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar
The impact of shortages of skilled labor force




Burimi: Qëndrapër Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 31: Ndikimi mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekure kepucëve
20,36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elektr.

FIGURA 32: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike
The impact of shortages on electricity in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 33: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of shortages on electricity in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekure kepucëve
20,36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elektr.

FIGURA 34: Vështirësitë financiare në sektorin e industrisë
Financial constrains in manufacture - total



Burimi: Qëndrapër Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 35: Vështirësitë financiare në industrinë e prodhimit sipas degëve të industrisë përpunuese
Financial constrains in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 Industria e tekstilëve dhe lekure kepucëve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve
21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elektr.

SEKTORI I NDERTIMIT

CONSTRUCTION SECTOR

Klima e biznesit

Besueshmëria në sektorin e ndërtimit është e përmirësuar në janar dhe prill. Treguesi i QKZH-së për besueshmërinë është në vlerën e -4 pikëve. Ky zhvillim konfirmohet edhe nga vlerësimet pozitive të aktivitetit të biznesit në tre muajt e fundit nga menaxherët në sektorin e ndërtimit. Gjithashtu, parashikimi i punësimit vazhdon të jetë në vlera pozitive, sipas përgjigjeve të pronarëve.

Kjo vlerë e ka kaluar për të dytën herë vlerën e mesatares shumëvjeçare 2002-2006. Edhe krahasuar me një vit më parë, klima e biznesit paraqitet lehtësisht e përmirësuar, duke ndryshuar vetëm me një pikë në përqindje.

Punësimi

Gjithashtu, parashikimi i punësimit vazhdon të jetë në vlera pozitive, sipas përgjigjeve të pronarëve. Por edhe pse në vlera pozitive prej 16 pikësh për prill 2007, punësimi parashikohet të ketë një shkallë më të ulët rritjeje se në janar 2007, dhe pikërisht me 7 pikë në përqindje më pak. Ndërsa krahasuar me një vit më parë është 3 pikë në përqindje më i lartë. Nëse kjo tendencë në rritje konstatohet edhe tremujorin e ardhshëm do të mund të flasim për një panoramë pozitive jo vetëm për punësimin por edhe për tregues të tjerë të rëndësishëm të sektorit të ndërtimit siç është edhe niveli i kontratave.


Niveli i kontratave

Në prill 2007 ndërtusit vazhdojnë të jenë të pa kënaqur për nivelin e kontratave që ata kanë lidhur aktualisht, duke i konsideruar ato jo të mjaftueshme për të siguruar vazhdueshmëri më të gjatë të punës së tyre. Megjithatë ata janë më pak pesimist se një tremujor më parë. Treguesi i këtij niveli ka pësuar një rritje në masën e 8 pikëve në përqindje nga janar 2007 (ku vlerësohej me -31 pikë) në prill 2007 (ku vlerësimi është -23 pikë).

Aktiviteti i ndërtimit në tre muajt e fundit


Gjatë anketimit të muajit prill 2007, vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit të kompanive të ndërtimit tregon për një zhvillim shumë negativ të këtij aktiviteti dhe për tremujorin në fjalë, deri në vlera negative nga 22% në janar 2007 në -8% në prill 2007, pra me një ndryshim negativ prej 30 pikësh në përqindje. Po të vemë re grafikun, në këto periudha të përmendura mund të dallohet qartazi se rënia e aktivitetit të ndërtimit në këtë periudhë është karakteristike, por periudha e fundit e analizuar mbart dhe rënien më të fortë për gjithë periudhën 2002 - 2007.

FIGURA 36: Treguesi i besueshmërisë së QKZH-së në sektorin e ndërtimit
CRD confidence indicator in construction sector




Burim: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 37: Parashikimi i punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit
Employment Expectation in construction sector (next 3 months)




Burim: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 38: Vlerësimi i nivelit të kontraktiveve në muajt në sektorin e ndërtimit
Work already contracted in months in construction sector - total



Burim: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 39: Vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit
Assessment of business activity in the last 3 months



Burim: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


Parashikimi i çmimeve

Rritja e çmimeve të ndërtimeve këtë tremujor shprehet me vlerën e 53 pikëve, një vlerë kjo që është më e larta historike. Pra ndërtuesit më fort se kurrë bashkohen në mendimin që çmimi i ndërtimeve të tyre do të jetë më i lartë. Nëse kjo vlerë e konstatuar e muajit prill do të krahasohej me një tre muajor më parë, do të shohim se ajo ka një rritje prej 27 pikësh në përqindje dhe 16 pikësh në përqindje më lartë se një vit më parë.

Kontratrat në muaj pune


Kontratrat e shprehura në muaj pune në muajin prill 2007 kanë rënë në nivelin e 7 muajve, nivel ky që është 1 muaj më i ulët se 3 muaj më parë dhe se një vit më parë. Përkeqësimi i muajve në kontraktime vazhdon të pasqyrojë përkeqësimin e nivelit të kontraktave të reja. Kjo rënie tregon shenja pasigurie për aktivitetin në të ardhmen në sektorin e ndërtimit. Kjo është dhe vlera më e ulët e kontraktimeve të siguruar për tre vitet e fundit (janar 2004 – prill 2007).

FIGURA 40: Parashikimi i çmimeve të ndërtimit
Price expectations in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim,

FIGURA 41 : Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në muaj në sektorin e ndërtimit
Work already contracted in months in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Pengesat në sektorin e ndërtimit Constraints within construction sector

Lejet e ndërtimit

Ndër 15 pyetjet e anketës që lidhen me kufizimet gjatë aktivitetit të ndërtimit, menjëherë bie në sy që ndërtuesit kanë shqetësim kryesor dhe shumë të fortë lejet e ndërtimit. Ky shqetësim në muajin prill 2007 është rritur në vlerën e 64 %, që do të thotë 20 pikë në përqindje më shumë se fillim viti 2007 ku shqetësimi ishte në vlerat e 44 pikëve.

FIGURA 42: Ndikimi i procedurave për leje ndërtimi
Building licensing procedures




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Legjislacioni fiskal


Nëse në muajin janar të 2007 vetëm 17% e të anketuarve shpreheshen të pakënaqur nga legjislacioni fiskal, ky shqetësim gjatë muajit prill është rritur, tashme në 36%. Gjithsesi kjo vlerë është 16 pikë në përqindje më e vogël se muaji prill i një viti më parë ku 54 % e të anketuarve shprehnin shqetësimin e ndikimit që ka legjislacioni fiskal në biznesin e tyre. Por rritja që pësoi në prill 2007 me 19 pikë në përqindje sjell në vëmendje se diskutimi mbi përmirësimin e mjedisit ekonomik të sektorit të ndërtimit është ende i hapur.

FIGURA 43: Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit
The impact of financial legislation




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 44: Ndikimi i mungesës së kërkeses ne sektorin e ndërtimit
Insufficient domestic demand




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim,

FIGURA 45 : Konkurrencë e pandershme nga tregu i zi në sektorin e ndërtimit
Unfair competition by black market in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 46: Ndikimi i mungesave të energjisë elektrike
The impact of shortages on electricity



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 47: Korrupsioni në organet tatimore
Corruption on tax department



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Kërkesa konsumatore

Kërkesa e pamjaftueshme konsumatore, si faktor pengues është në nivele lehtësisht më të ulta se mesatarja vjetore 2002-2006. Për të dytin tremujor rresht ajo vlerësohet nga 21 % e ndërtuesve si pengese në vazhimesinë normale të procesit të ndërtimit. Gjithsesi, vlerësimet e tyre tregojnë një situatë të përgjithshme optimiste.

Tregu informal

Konkurrenca e pandershme nga tregu i zi duket se është shfaqur përsëri me një vlerë në rritje në krahasim me një periudhë më parë duke kapur vlerën e 25 pikëve, që do të thotë 7 pikë në përqindje më shumë krahasuar me fillimin e vitit, ku ky parametër është në vlerën e 18 pikëve dhe 2 pikë në përqindje më shumë krahasuar me një vit më parë. Por edhe pse kemi një rritje të tillë përsëri mund të themi që kjo vlerë është 15 pikë në përqindje më e vogël se mesatarja e harkut kohor 2003- 2007. Gjithashtu ky volatilitet i saj tregon çrregullsinë e tregut informal.

Energjia elektrike

Situata e vështirë energjitike në fillim të vitit që shqetësoi shumicën e ndërtuesve, duket se ka një përmirësim të ndjeshëm në prill 2007, pasi mungesa e energjisë elektrike në këtë periudhë nuk duket të jetë penguese për ecurinë në procesin e tyre. Ky faktor sezonal vërtet vjen i përmirësuar në këto periudha por nuk ka një siguri në vazhdim, do të jetë shumë interesant vlerësimi i tij për periudhën e ardhshme.

Korrupsioni i organeve tatimore

Nga figura 47 vërehet një rënie e vazhdueshme në vlerësimin e pengesës së korrupsionit në organet tatimore që nga prill 2005, ku vlerësohej si pengesë nga 44% e ndërtuesve të anketuar, në prill 2007, e përmendur vetëm nga 8% e tyre. Kjo tregon për një zhvillim pozitiv drejt përmirësimit të mentalitetit të biznesit në lidhje me zbatimin korrekt të procedurave të organeve tatimore.

TË PËRGJITHSHME

Gjatë anketimit të muajit prill 2007 u kontaktuan rreth 600 firma në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit në rrethet Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Shkodër. nga të cilat u përgjigjën brenda periudhës së anketimit, rreth 460 firma. Anketimi i biznesit në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit ka filluar në muajt janar dhe prill të vitit 2002. Anketimi bazohet mbi vlerësimin cilësor të opinionëve të menaxherëve apo pronarëve të ndërmarrjeve të kontaktuar. Vlerësimet cilësore përpunohen në formën e treguesit të Balancës, e cila shpreh diferencën midis përgjigjeve optimiste (në rritje, apo përmirësim) kundrejt atyre pesimiste (në ulje, apo përkeqësim) duke përjashtuar nga vlerësimi opinionet që shprehin situatë të pandryshuar. Në këtë mënyrë kur balanca e përgjigjeve është pozitive vlerësimet e optimistëve tejkalojnë ato të pesimistëve dhe në të kundërtën do të kishim një balancë negative. Klima e biznesit vlerësohet nëpërmjet indikatorit të besueshmërisë. Ky indikator për sektorin e industrisë përpunuese llogaritet si mesatare aritmetike e tre indikatorëve: parashikimit të prodhimit, vlerësimin e kontratave të realizuara, dhe vlerësimin e produktit të gatshëm (i marrë me shenjë të kundërt). Për sektorin e ndërtimit indikator i besueshmërisë llogaritet si mesatare aritmetike e treguesit mbi vlerësimin e kontraktiveve aktuale dhe parashikimit të punësimit.

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është kryerja e studimeve dhe analizave ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit nëpërmjet anketimeve periodike. Duke analizuar problematikat e biznesit dhe publikut dhe shpërndarjen e rezultateve synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të jetës të të gjithë qytetarëve.

Drejtoresha Ekzekutive/ *Executive Director*:
Mirlinda Rusi (Gajo)

Anëtarët e grupit / *Group's members*
Komola Sako
Rozi Beqiri
Bexhet Hyka

Duke ndjekur të njëjtën praktikë për periudha rigorozisht të përcaktuara (mujore apo tremujore), mbi bazën e balancave ndërtohen indikatorë të caktuar të biznesit që shprehin situatën e biznesit në raport me periudhat e mëparshme, situatën aktuale dhe parashikimin për një periudhë të paktën 3 mujore. Anketimet e biznesit shërbejnë, gjithashtu, jo vetëm për të ndjekur tendencën e biznesit, por me anë të tyre diktohen ciklet e biznesit, si dhe pikat e kthesës në ciklin e biznesit.

Kjo metodë anketimi zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet Kandidate, si dhe me pak ndryshime në të gjitha vendet anëtare të OECD-së. Në Evropë, një nga institutet më prestigjioze që ka filluar anketimet cilësore të biznesit është KOF Instituti Zvicerian për Analizën e Ciklit të Biznesit në Zyrih, Zvicër (viti 1955). Stafi teknik i QKZH-së në periudhën 8 -12 qershor 2005 ka marrë pjesë në tavolinat e punës të organizuara nga KOF posaçërisht për rritjen e kapaciteteve teknike të saj në fushat specifike si: hartim metodologjie për përzgjedhjen e kampionit në sektorët e industrisë përpunuese dhe ndërtimit për Shqipërinë; analizë ekonomike për interpretim të rezultateve në lidhje me tendencën e biznesit dhe vlerësimin e indikatorëve sintetike; implementim teknik të tendencave sipas anketimit në bizneset industri përpunuese dhe ndërtim.

CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publish research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.